<p>4. Për mallin që i është deklaruar zyrës doganore mundësohet trajtimi i lejuar doganor apo përdorimi, pas kryerjes së analizës së riskut.</p> <p style="text-align: center;">Neni 93/J</p> <p>1. Kur avioni aterron në më shumë se në një aeroport në territorin doganor dhe nisat mes këtyre aeroporteve pa aterruar në aeroport jashtë territorit doganor, deklarata përmbledhëse hyrëse dorëzohet në aeroportin e parë në Kosovë, për gjithë mallin që transportohet.</p> <p>2. Autoriteti doganor në aeroportin e parë të hyrjes kryen analizën e riskut, kurse analiza shtesë e riskut mund të kryhet në aeroportin ku bëhet shkarkimi mallit.</p> <p>3. Nëse vërtetohet se ekziston rreziku, Dogana e Kosovës para aeroportit hyrës, merr masat e ndalimit të mallit që paraqet rrezik për të cilin është e nevojshme intervenimi dhe ia procedon rezultatet e analizës së riskut aeroporteve të tjera.</p> <p>4. Në aeroportet e tjera në territorin doganor, për mallin që deklarohet në Doganë në atë aeroport, zbatohen dispozitat e nenit 96 dhe 97 të Udhëzimit Administrativ bazik.</p>	<p>4. For the goods which is declared in the customs office, the allowed customs treatment or use can be enabled, after the risk analysis is concluded.</p> <p style="text-align: center;">Article 93/J</p> <p>1. When an airplane lands in more than one airport in the customs territory and departs between these airports without landing in airports outside of the customs territory, the entry summary declaration shall be submitted in the first airport in Kosovo, for all of the goods being transported.</p> <p>2. The customs authority in the first airport performs the risk analysis, whereas the additional risk analysis can be done at the airport where the goods' unloading occurs.</p> <p>3. If ascertained that there is risk involved, the customs authorities of airport of entry, shall take the measures to stop the goods that pose risk for which an intervention is needed and processes the risk analysis results to other airports as well.</p> <p>4. In other airports of the customs territory, for the goods declared in customs in that airport, the provisions from article 96 and 97 of the basic Administrative.</p>	<p>4. Za robu koja je prijavljena carinarnici može se odobriti carinski dozvoljeno postupanje ili upotreba, nakon obavljene analize rizika.</p> <p style="text-align: center;">Član 93/J</p> <p>1. Kada vazduhoplov slijeće na više od jednog aerodroma u carinskom području i kreće se između aerodroma bez slijetanja na aerodrom van carinskog područja, ulazna sigurnosna sažeta deklaracija podnosi se na prvom aerodromu u Kosovo, za svu robu koja se prevozi.</p> <p>2. Carinski organ na prvom aerodromu ulaska vrši analizu rizika, a dodatna analiza rizika robe može se izvršiti na aerodromu gdje se vrši istovar robe.</p> <p>3. Ako se utvrdi da postoji rizik, Carina Kosova prve ulaznog aerodroma preduzima mjere zabrane za robu, koja predstavlja veliki rizik za koji je potrebna intervencija i prosleđuje rezultate analize rizika sledećim aerodromima.</p> <p>4. U sledećim aerodromima na carinskom području, za robu koja se prijavljuje carini u tom aerodromu primjenjuju se odredbe člana 93 i 97 bazičnog Administrativnog Uputstva.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 94 /K</p> <p>1. Transportuesi i mjetit aktiv transportues, që hyn në territorin doganor apo përfaqësuesi i tij e njofton zyrën e parë hyrëse doganore, për arrijtjen e mjetit transportues.</p> <p>2. Njoftimi nga paragrafi 1 i këtij neni, përmban të gjitha të dhënat e nevojshme për identifikimin e deklaratave përmbledhëse importuese, që janë dorëzuar për mallin që transportohet me atë mjet transporti</p>	<p style="text-align: center;">Article 94/K</p> <p>1.The transporter of the active transport means that enters in the customs territory, or his representative shall notify the first customs office of entry for the arrival of the transport means.</p> <p>2.The notification from paragraph 1 of this article, shall contain all the necessary data to identify the import summary declarations which are submitted for the goods being transported by those means of transport.</p>	<p style="text-align: center;">Član 94/K</p> <p>1.Prevoznik aktivnog prevoznog sredstva koji ulazi na carinsko područje, ili njegov zastupnik obavještava prvu ulaznu carinarnicu o dolasku prevoznog sredstva.</p> <p>2.Obavještenje iz stava 1 ovog člana, sadrži sve podatke neophodne za identifikaciju uvoznih sažetih deklaracija podnijetih za robu koja se prevozi tim prevoznim sredstvom</p>
<p style="text-align: center;">Neni 5</p> <p>Neni 127 i Udhëzimit Administrativ bazik ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:</p> <p>1. Kur deklarata dorëzohet nëpërmjet sistemit elektronik të shkëmbimit e të dhënave, të dhënat nga deklarata me shkrim zëvendësohen, duke ia dërguar zyrës kompetent doganor me qëllim të përpunimit elektronik e të dhënave të koduara, apo të dhënat në çfarëdo forme tjetër, që i përcakton Dogana e Kosovës, që korrespondon me të dhënat e nevojshme, referuar në Aneksin 18 për deklaratën me shkrim.</p> <p>2. Kur një deklaratë është përpunuar në formatin e sistemit XML, konsiderohet si mesazhi i përcjellur për Doganën e Kosovës, pasi që një mesazh i tillë të jetë pranuar nga Dogana e Kosovës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 5</p> <p>Article 127 of the basic Administrative Instruction is amended and supplemented as it follows,</p> <p>1.When the declaration is submitted through the data exchange electronic system, the data from the written declaration are replaced by being sent to the competent customs office with the purpose of electronic processing, the coded data or the data of any other form that is determined by Kosovo Customs, and which correspond with the necessary data referred in Annex 18 for the declaration in writing.</p> <p>2.The declaration is considered to have been done with the XML system message submitted to Kosovo Customs when such message is received by Kosovo Customs.</p>	<p style="text-align: center;">Član 5</p> <p>Član 127 bazičnog Administrativnog Uputstva menja se i glasi:</p> <p>1.Kada se deklaracija podnosi sistemom elektronske razmjene podataka, podaci iz pisane deklaracije, zamjenjuju se slanjem nadležnom carinskom organu, radi elektronske obrade, šifriranih podataka ili podataka u bilo kojem drugom obliku koji odredi Carina Kosova, a koji odgovaraju podacima potrebnim za pisane deklaracije iz Aneksa 18.</p> <p>2.Smatra se da je deklaracija izrađena sistemom XML formata poruka podnijeta Carini Kosova, kada Carina Kosova primi takvu poruku.</p>

<p>3. Zyra doganor e konfirmon pranimin e mesazhit XML, me mesazhin kthyes që përmban të gjitha të dhënat identifikuese për secilën deklaratë, llojin e gabimeve të vërejtura nëse nuk është në rregull, dhe/apo numrin dhe datën e pranimit të deklaratës.</p> <p>4. Nëse deklarata doganore bëhet me sistemin e mesazheve XML, Dogana e Kosovës i përcakton rregullat për zbatimin e dispozitave të përcaktuara me nenin 152 të Udhëzimit Administrativ bazik.</p> <p>5. Nëse deklarata dorëzohet në mënyrë elektronike, dorëzuesi i deklaratës doganore njoftohet për lëshimin e mallit, me ç’rast shënohen numri i deklaratës dhe data e lëshimit.</p> <p>6. Nëse të dhënat nga deklarata futen në sistemin e Doganës së Kosovës, atëherë zbatohen paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni.</p>	<p>3. The customs office confirms the XML message admission, with a return message which contains all the identifying data for each declaration, the type of mistakes notices if not in order, and/or the number and date when the declaration is admitted.</p> <p>4. If the customs declaration is done with the XML system message, Kosovo Customs shall determine the rules for implementing the provisions set out by article 152 of basic Administrative Instruction.</p> <p>5. If the declaration is submitted electronically, the customs declaration submitter is notified for the goods release, in which case a declaration number and the date of release is written.</p> <p>6. If the data from the declaration are inserted in the customs system, then paragraphs 2, 3 and 4 of this article are applied.</p>	<p>3. Carinarnica potvrđuje prijem XML poruke povratnom porukom koja sadrži sve dogovorene identifikacione podatke o svakoj deklaraciji, vrstu uočenih grešaka ako je neispravna, i/ili broj i datum prihvatanja deklaracije.</p> <p>4. Ako se carinska deklaracija izrađuje sistemom XML poruka, Carina Kosova određuje pravila za primjenu odredaba propisanih članom 152 bazičnog Administrativnog Uputstva.</p> <p>5. Ako se deklaracija podnosi elektronskim putem, podnosilac carinske deklaracije se obavještava o puštanju robe, pri čemu se navodi broj deklaracije i datum puštanja.</p> <p>6. Ako se podaci iz deklaracije unose u carinski infomacioni sistem shodno se primjenjuju st. 2, 3 i 4 ovog člana.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 6</p> <p>Neni 128 i Udhëzimit Administrativ bazik ndryshohet me tekstin si në vijim:</p> <p>1. Autorizimin për shkëmbimin elektronik e të dhënave, Dogana e Kosovës ia lëshon çdo personi sipas kërkesës me shkrim. Udhëzimin e brendshëm për lëshimin e autorizimit për shkëmbimin elektronik e të dhënave e miraton Drejtori i Doganës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 6</p> <p>Article 128 of the basic Administrative Instruction is modified as it follows:</p> <p>1. The authorization for electronic exchange of data, Kosovo Customs issues to each person, based on the written request. The Internal Instruction for issuing authorizations for electronic exchange of data is brought by the Director General.</p>	<p style="text-align: center;">Član 6</p> <p>Član 128 bazičnog Administrativnog Uputstva menja se i glasi:</p> <p>1. Odobrenje za elektronsku razmjenu podataka izdaje Carina Kosova svakom licu, na njegov pisani zahtjev. Interno Uputstvo o izdavanju odobrenja za elektronsku razmjenu podataka izdaje direktor Carina Kosova</p>

<p>2. Autorizimi nga paragrafi 1 i këtij neni do të anulohet, nëse subjektit ekonomik apo ndërmarrësit i anulohet autorizimi për çështjet e përfaqësimit sipas nenit 10 dhe 11 të Kodit doganor dhe i Akcizave. Autorizimi i lëshuar mund të anulohet edhe nëse:</p> <p>2.1. Dogana e Kosovës, konstaton se të dhënat që janë dhënë në formë elektronike nuk janë identike me të dhënat në deklaratën doganore me shkrim;</p> <p>2.2. Paraqiten rrethanat në të cilat pjesëmarrësi në shkëmbimin elektronik e të dhënave nuk i plotëson më kërkesat teknike të përshkruara në Udhëzim. Struktura e komunikimeve elektronike përcaktohet me autorizimin nga paragrafi 1 i këtij neni.</p> <p>3. Nëse plotësimi i formaliteteve të tjera kërkon kopjen e deklaratës doganore me shkrim, me kërkesë të paraqitësit të deklaratës doganore, e njëjta paraqitet dhe vuloset edhe te zyra doganore kompetente apo ashtu siç është përcaktuar me nenin 4 të këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7</p> <p>Pas nenit 143 të Udhëzimit Administrativ bazik shtohet nenet e reja 143/A, 143/B, 143/C, 143/Ç dhe 143/D, me tekstin si në vijim:</p>	<p>2.The authorization from paragraph 1 of this article will be cancelled if to the economic subject or the entrepreneur authorization is cancelled for the issues of representation from article 10 and 11 of the Customs and Excise Code. The issued authorization can be cancelled if:</p> <p>2.1.Kosovo Customs ascertains that the data provided electronically are not identical with the data in the written customs declaration;</p> <p>2.2.The circumstances appear when the participant in the electronic data exchange doesn't fulfil the technical requirements prescribed in the instruction. The electronic communications structure is determined by the authorization from paragraph 1 of this article.</p> <p>3.If the completion of other formalities requires a copy of the written customs declaration, by request from the customs declaration submitter, the same is submitted and stamped by the competent customs office or as determined by article 4 of this Instruction.</p> <p style="text-align: center;">Article 7</p> <p>After article 143 of the Instruction, new articles such as 143/A, 143/B, 143/C, 143/Ç and 143/D "Express Deliveries" are added.</p>	<p>2.Odobrenje iz stava 1 ovog člana će se poništiti ako se privrednom društvu ili preduzetniku poništi odobrenje za poslove zastupanja iz člana 10 i 11 Carinskog zakonika. Izdato odobrenje može se poništiti i ako:</p> <p>2.1.Carina Kosova utvrdi da podaci dati u elektronskom obliku nijesu istovjetni sa podacima u pisanoj carinskoj deklaraciji;</p> <p>2.2.Nastupe okolnosti u kojima učesnik u elektronskoj razmjeni podataka više ne ispunjava tehničke uslove propisane uputstvom. Struktura elektronskih saopštenja određuje se odobrenjem iz stava 1 ovog člana.</p> <p>3.Ako se za završetak drugih formalnosti zahtijeva primjerak carinske deklaracije u pisanoj formi, na zahtjev podnosioca carinske deklaracije, isti se podnosi i ovjerava ili kod nadležne carinarnice ili na način propisan članom 4 ovog uputstva.</p> <p style="text-align: center;">Član 7</p> <p>Iza člana 143 bazičnog Administrativnog Uputstva dodaju se novi članci 143/A, 143/B, 143/C, 143/Č i 143/D, i glase:</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 143/A</p>	<p style="text-align: center;">Article 143/A</p>	<p style="text-align: center;">Član 143/A</p>
<p>1. Me kërkesë të personit juridik i cili ofron shërbime të bartjes dhe dorëzimit të dërgesave të shpejta (në tekstin e mëtejshëm: operatori i dërgesave të shpejta/ ekspres), zyra doganore mund të lëshojë autorizim për deklarimin e dërgesave të shpejta në procedurë të veçantë/ thjeshtëzuar.</p>	<p>1.By request from the legal person who provides services for transport and delivery of express deliveries (hereinafter: express deliveries operator), the customs office may issue an authorization for the declaration of express deliveries in a special procedure/simplified procedure.</p>	<p>1.Carinarница može, na zahtjev pravnog lica koje pruža usluge prenosa i uručenja ekspresnih pošiljki (u daljem tekstu: operator ekspresnih pošiljki), izdati odobrenje za deklarisanje ekspresnih pošiljki u posebnom/pojednostavljenom postupku.</p>
<p>2. Dërgesat e shpejta nga paragrafi 1 i këtij neni janë artikuj të veçantë të transportuara nga një shërbim i shpejtë unik i marrjes, transportit, zhdoganimit dhe dorëzimit të paketave dhe të kufizuara kohore, me ç’ rast gjatë gjithë kohës sa zgjat shërbimi, dërgesa mbikëqyret dhe përcillet lokacioni i saj.</p>	<p>2.The express deliveries from paragraph 1 of this article are special items transported by an express unique service of receipt, transport, clearance and delivery of packages and with limited time, in which case during the entire time the service lasts, the delivery is supervised and its location is followed.</p>	<p>2.Ekspresne pošiljke iz stava 1 ovog člana su pojedinačni predmeti koji se prevoze jedinstvenom službom ekspresnog i vremenski ograničenog preuzimanja, prevoza, carinjenja i dostave paketa pri čemu se tokom čitavog trajanja usluge pošiljka nadzire i prati njena lokacija.</p>
<p>3. Për shkak të urgjencës së procedurës me dërgesat e shpejta, operatori i dërgesave të shpejta mund ta njoftojë Doganën e Kosovës, për arrijtet e dërgesave sipas manifestit të konsoliduar (përmbledhës), që e zëvendëson deklaratën përmbledhëse, përkatësisht deklaratën përmbledhëse hyrëse para se të arrijnë dërgesat.</p>	<p>3.Due to the procedure’s urgency with express deliveries, the express deliveries operator can notify the customs authority on the arrival of deliveries as per the summarized manifest which replaces the summary declaration, respectively the entry summary declaration prior to deliveries arrival.</p>	<p>3.Zbog hitnosti postupka sa ekspresnim pošiljkama, operator ekspresnih pošiljki može carinskom organu da najavi prispijeće pošiljki po konsolidovanom (zbornom) manifestu, koji zamjenjuje sažetu prijavu, odnosno ulaznu sigurnosnu sažetu deklaraciju, prije prispijeća pošiljki.</p>
<p>4. Manifesti i konsoliduar nga paragrafi 3 i këtij neni dorëzohet në afatet e përcaktuara me nenin 93/G të këtij Udhëzimi Administrativ.</p>	<p>4.The summarized manifest from paragraph 3 of this article is submitted in periods of time determined by article 93/G of this Administrative Instruction.</p>	<p>4.Konsolidovani manifest iz stava 3 ovog člana podnosi se u rokovima propisanim članom 93 /G ovog uputstva.</p>
<p>5. Të dhënat nga manifesti që dorëzohet për dërgesat e shpejta individuale e bëjnë deklaratën e veçantë doganore sipas nenit 80, paragrafi 1 i</p>	<p>5.The data from the manifest which is submitted for individual express deliveries make the special customs declaration in view of</p>	<p>5.Podaci iz manifesta koji se odnose na pojedinačne ekspresne pošiljke čine posebnu carinsku deklaraciju u smislu člana 80, stav 1</p>

<p>Kodit Doganor dhe Akcizave, me përjashtim të dërgesave që përmbajnë mallra, të cilat u nënshtrohen ndalesave dhe kufizimeve dhe procedurave të tjera doganore, që nuk përfshijnë lëshimin e mallit në qarkullim të lirë.</p> <p>6.Për personat fizikë të cilët pranojnë dërgesa që nuk i nënshtrohen pagesës së detyrimeve importuese, operatorit të dërgesave të shpejta për zhdoganim nuk i duhet autorizimi dhe as kopja e letërnjoftimit të pranuesit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 143/B</p> <p>1. Dërgesat e shpejta postare në manifest grupohen sipas kësaj renditjeje:</p> <p>1.1. dërgesat që personi fizik nga bota e jashtme ia dërgon personit fizik në Kosovë dhe dërgesat me vlerë të vogël, që nuk i nënshtrohen pagesës së detyrimeve të importit;</p> <p>1.2.dërgesat që përmbajnë material reklamues dhe mostra, që pa kompensim pranohen nga bota e jashtme, për të cilat nuk paguhen detyrimet e importit;</p> <p>1.3.dërgesat për të cilat mund të lindë borxhi doganor, e të cilat nuk i nënshtrohen masave të politikës tregtare; dhe</p> <p>1.4.dërgesat që përmbajnë mallra, që i nënshtrohen masave të politikës tregtare apo mallit i cili përkohësisht importohet.</p>	<p>article 80, paragraph 1 of the Customs and Excise Code, by exception of deliveries containing goods which are subject to prohibitions and limitations and other customs procedures which do not include the release of goods to free circulation.</p> <p>6.For natural persons who receive deliveries which are not subject to import duties, the express deliveries operator doesn't need the authorization neither the copy of the recipients ID card for clearance.</p> <p style="text-align: center;">Article 143/B</p> <p>1.The express mail deliveries in the manifest are grouped as per this order:</p> <p>1.1.deliveries that the natural person sends from abroad to the natural person in Kosovo and deliveries with small values are not subject to import duties payment;</p> <p>1.2.deliveries which contain advertising material and samples which without compensation are received from abroad, for which import duties shall not be paid;</p> <p>1.3.deliveries for which the customs debt may arise and which are not subject to the commercial policy measures;</p> <p>1.4.deliveries which contain goods that are subject to trade policy measures or goods which are temporarily imported.</p>	<p>tačka 1 Carinskog zakona, sa izuzetkom pošiljki koje sadrže robe koje podliježu zabranama i ograničenjima i drugim carinskim postupcima koji ne obuhvataju stavljanje robe u slobodan promet.</p> <p>6.Za fizička lica koja primaju pošiljke koje ne podliježu plaćanju uvoznih dažbina, operateru ekspresnih pošiljki za carinjenje nije potrebno ovlašćenje ni kopija lične karte od primaoca.</p> <p style="text-align: center;">Član 143/B</p> <p>1.Ekspresne poštanske pošiljke se u manifestu grupišu po sljedećem redosljedu:</p> <p>1.1.pošiljke koje fizičko lice iz inostranstva šalje fizičkom licu u Kosovo i pošiljke neznatne vrijednosti, koje ne podliježu plaćanju uvoznih dažbina;</p> <p>1.2.pošiljke koje sadrže reklamni materijal i uzorke koji se bez naknade primaju iz inostranstva, na koje se ne plaćaju uvozne dažbine;</p> <p>1.3.pošiljke za koje može nastati carinski dug, a koje ne podliježu mjerama trgovinske politike;</p> <p>1.4.pošiljke koje sadrže robu koja podliježe mjerama trgovinske politike ili roba kojna se privremeno uvozi.</p>
--	--	---

<p>2.Procedura e zhdoganimit të dërgesave nga paragrafi 1 i këtij neni, kryhet sipas grupeve të deklaruara të dërgesave.</p> <p style="text-align: center;">Neni 143/C</p> <p>1. Nëse dërgesa sipas nenit 143/B, nën paragrafi 1.3, të këtij Udhëzimi Administrativ nuk i është dorëzuar pranuesit, operatori i dërgesave të shpejta ka të drejtë mbi bazën e kushteve ligjore në kthimin e detyrimeve importuese të paguara, në bazë të dëshmimeve se dërgesa e ka lëshuar territorin doganor.</p> <p>2. Dërgesat sipas nenit 143/B, nën paragrafi 1.1 dhe 1.2, të këtij Udhëzimi Administrativ lirohen, duke vendosur shënimet në manifestim e konsoliduar, kurse për dërgesat sipas nenit 143/B, nën paragrafi 1.3, të këtij Udhëzimi, operatori i dërgesave të shpejta paraqet deklaratën shtesë brenda shtatë (7) ditësh nga data e arritjes.</p> <p>3. Dogana e Kosovës njofton operatorin e dërgesave të shpejta për dërgesat të cilat janë caktuar për ekzaminim fizik apo janë përjashtuar nga procedura e dërgesave të shpejta.</p> <p style="text-align: center;">Neni 143/ Ç</p> <p>1. Manifesti për secilën dërgesë të shpejtë individuale përmban këto të dhëna:</p>	<p>2.The clearance procedure for deliveries from paragraph 1 of this article is done according to the declared groups of deliveries.</p> <p style="text-align: center;">Article 143/C</p> <p>1.If the delivery from article 143/B, paragraph 1, clause 1.3 of this Instruction is not submitted to the recipient, the express deliveries operator is entitled based on legal terms to return the paid import duties, based on proofs that the delivery left the customs territory.</p> <p>2.The deliveries from article 143/B, paragraph 1, clause 1.1 and 1.2 of this Administrative Instruction, are released by placing a note in the summarized manifest, whereas for deliveries from article 143/B, paragraph 1, clause 1.3 of this Instruction, the express deliveries operator shall present an additional declaration within seven (7) days from the date of arrival.</p> <p>3.Customs authorities shall notify the express deliveries operator for the deliveries which are determined for physical examination or are excluded from the express deliveries procedure.</p> <p style="text-align: center;">Article 143/Ç</p> <p>1.The manifest for each individual express delivery shall contain the following data:</p>	<p>2.Postupak carinjenja pošiljki iz stava 1 ovog člana vrši se po prijavljenim grupama pošiljaka.</p> <p style="text-align: center;">Član 143/C</p> <p>1.Ako pošiljka iz člana 143/B, tačka 1.3 ovog uputstva nije uručena primaocu, operator ekspresnih pošiljki ima pravo na povraćaj plaćenih uvoznih dažbina, na osnovu dokaza da je pošiljka napustila carinsko područje.</p> <p>2.Pošiljke iz člana 143/B, tačka 1.1 i 1.2 ovog uputstva puštaju se stavljanjem zabilješke na konsolidovanom (zbirnom) manifestu, a za pošiljke iz člana 143/B, stav 1, tačka 1.3 ovog uputstva operator ekspresnih pošiljki podnosi dopunsku deklaraciju u roku od sedam (7) dana od dana prispjeća.</p> <p>3.Carina Kosova će obavijestiti operatora ekspresnih pošiljki o pošiljkama koje su određene za pregled ili su isključene iz postupka ekspresnih pošiljki.</p> <p style="text-align: center;">Član 143/Č</p> <p>1.Manifest za svaku individualnu ekspresnu pošiljku treba da sadrže sljedeće podatke:</p>
--	---	--

<p>1.1.emrin dhe adresën e dërguesit/eksportuesit;</p> <p>1.2.emrin dhe adresën e marrësit/importuesit;</p> <p>1.3.përshkrimin e mallit;</p> <p>1.4.numrin e paketës/ peshë;</p> <p>1.5.numrin e dokumentit transportues;</p> <p>1.6.shtetin e origjinës;</p> <p>1.7.vendin e ngarkimit;</p> <p>1.8.numrin, datën dhe dhënien e faturës; dhe</p> <p>1.9.numrin identifikues fiskal/biznesit të pranuesit/importuesit, nëse është i qasshëm dhe nëse mund të përdoret.</p>	<p>1.1.name and address of the consignor/exporter;</p> <p>1.2.name and address of consignee/importer,;</p> <p>1.3.description of goods;</p> <p>1.4.number of package/weight,;</p> <p>1.5.number of transport document;</p> <p>1.6.country of origin;</p> <p>1.7.place of loading;</p> <p>1.8.number, date and invoice provider;</p> <p>1.9.fiscal identification number/business of the recipient/importer, is accessible and if can be used.</p>	<p>1.1.ime i adresu pošiljaoca/izvoznika;</p> <p>1.2.ime i adresu primaoca/uvoznika;</p> <p>1.3.opis robe;</p> <p>1.4.broj koleta/težina;</p> <p>1.5.broj prevozne isprave;</p> <p>1.6.državu porijekla;</p> <p>1.7.mjesto utovara;</p> <p>1.8.broj, datum i izdavaoca fakture;</p> <p>1.9.poreski identifikacioni broj (PIB) primaoca/uvoznika, ako je dostupan i ako se može koristiti.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 143/D</p> <p>1.Në procedurën e dërgesave të shpejta ndaj operatorit të dërgesave të shpejta, zbatohen dispozitat që kanë të bëjnë për përfaqësim nga neni 10 dhe 11 të Kodit Doganor dhe i Akcizave.</p> <p>2.Varësisht nga disponueshmëria e teknologjisë së informacionit, procedura me dërgesa të shpejta kryhet nëpërmjet shkëmbimit elektronik e të dhënave, sipas nenit 5 të këtij udhëzimi.</p>	<p style="text-align: center;">Article 143/D</p> <p>1.In the express deliveries procedure, the provisions having to do with representation from article 10 and 11 of the Customs and Excise Code are applied.</p> <p>2.Depending on the information technology availability, the express deliveries procedure shall be done via the electronic data exchange, according to article 5 of this instruction.</p>	<p style="text-align: center;">Član 143/D</p> <p>1.U postupku sa ekspresnim pošiljkama na operatora ekspresnih pošiljki primjenjuju se odredbe koje se odnose na zastupanje iz člana 10 i 11 Carinskog zakona.</p> <p>2.U zavisnosti od dostupnosti informacione tehnologije, procedura sa ekspresnim pošiljkama će se sprovođiti putem elektronske razmjene podataka, prema članu 5 ove upustva.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 8</p> <p>1. Pas nenit 366 të Udhëzimit Administrativ bazik, shtohen nenet shtesë: 366 /A, 366 /B, 366 /C, 366 /Ç, 366/ D dhe 366/ DH, si në vijim:</p> <p style="text-align: center;">Neni 366/A Deklarata përmbledhëse dalëse</p> <p>1.Nëse largimi i mallrave nga territori doganor nuk kërkon deklaratë doganore, deklaratata përmbledhëse paraqitet në zyrën doganore dalëse.</p> <p>2.Zyra dalëse sipas të këtij Udhëzimi është:</p> <p>2.1.Zyra doganore kompetente për vendin nga ku malli largohet nga territori doganor; ose</p> <p>2.2.në rastet kur malli largohet nga territori doganor nëpërmjet transportit ajror, zyra doganore e daljes është zyra doganore kompetente për vendin ku mallrat janë ngarkuar në avion.</p> <p>3. Nëse deklaratata transite elektronike përmban të dhënat e deklaratës përmbledhëse dalëse, nuk kërkohet deklaratata përmbledhëse dalëse me kusht që zyra doganore e destinacionit është edhe zyra doganore dalëse apo nëse zyra doganore e destinacionit është jashtë territorit doganor.</p>	<p style="text-align: center;">Article 8</p> <p>1. After article 366 of the basic Administrative Instruction, additional articles are added, such as: 366/A, 366/B, 366/C, 366/Ç, 366/D and 366 /DH, as in the following:</p> <p style="text-align: center;">Article 366/A The exit summary declaration</p> <p>1.If the departure of goods from customs territory doesn't require a customs declaration, the summary declaration is presented to the customs office of exit.</p> <p>2.The office of exit for the purposes of this Instruction is:</p> <p>2.1.the competent customs office for the place where the goods will depart from the customs territory; or</p> <p>2.2.in cases when goods depart from the customs territory via air transport, the customs office of exit is the competent office for the place where were loaded in the airplane.</p> <p>3.If the electronic transit declaration contains the exit summary declaration data, then the exit summary declaration is not required provided that the customs office of destination is also the customs office of exit or if the customs office of destination is outside of the customs territory.</p>	<p style="text-align: center;">Neni 8</p> <p>1.Iza člana 366 bazičnog Administrativnog Uputstva, dodaju se članci: 366/A, 366/B, 366/C, 366/Č, 366/D i 366/DH, kako sledi:</p> <p style="text-align: center;">Član 366/A Izlazna sigurnosna sažeta deklaracija</p> <p>1.Ako iznošenje robe sa carinskoga područja ne zahtijeva carinsku deklaraciju, izlazna sigurnosna sažeta deklaracija podnosi se izlaznoj carinarnici.</p> <p>2.Izlazna carinarnica u smislu ove uredbe je:</p> <p>2.1.carinarnica nadležna za mjesto iz kojega će roba napustiti carinsko područje; ili</p> <p>2.2.u slučaju kada će roba napustiti carinsko područje vazdušnim saobraćajem, carinarnica nadležna za mjesto gdje se roba utovara na vazduhoplov na kojem će biti odvedena na odredište izvan carinskog područja.</p> <p>3.Ako elektronska tranzitna deklaracija sadrži podatke iz izlazne sigurnosne sažete deklaracije, nije potrebna izlazna sigurnosna sažeta deklaracija pod uslovom da je odredišna carinarnica takođe izlazna carinarnica ili da je odredišna carinarnica izvan carinskog područja.</p>
--	--	--

<p>4. Deklarata përmbledhëse dalëse nuk kërkohet:</p> <p>4.1. në rastet e parapara nga neni 93 /Ç i këtij Udhëzimi Administrativ;</p> <p>4.2. kur malli ngarkohet në aeroport në territorin doganor, kurse procedura kryhet në një aeroport tjetër në territorin doganor, me kusht që zyra doganore e daljes të sigurojë dëshmi në formë të një manifesti tregtar transporti ose një listë të mallrave/paketave në disa dërgesa në lidhje me vendin e planifikuar të shkarkimit, vlen edhe kur një avion që transporton mallra ka nevojë për aterrim ose ndalje në aeroport jashtë territorit doganor dhe se mallrat mbeten të ngarkuara në avion gjatë uljes ose ndaljes në një aeroport jashtë territorit doganor;</p> <p>4.3. kur në aeroport malli nuk është shkarkuar nga mjeti transportues që e ka transportuar në territorin doganor dhe i cili transporton jashtë territorit doganor;</p> <p>4.4. kur malli është ngarkuar në aeroportin paraprak në territorin doganor dhe mbetet në mjetin transportues i cili bartë jashtë territorit doganor;</p> <p>4.5. kur mallrat në strehim të përkohshëm ose në një zonë të lirë nën mbikëqyrjen e të njëjtit autoritet doganor janë ringarkuar nga mjetet e transportit, që i kanë bartur deri në atë objekt për strehim të përkohshëm ose në zonat e lira në avion ose në vagon, që transferohet nga ai</p>	<p>4.The exit summary declaration is not required:</p> <p>4.1.in cases from article 93/Ç of this Instruction;</p> <p>4.2.when the goods are loaded in the airport of the customs territory, whereas the procedure is performed in another airport of the customs territory, provided that the customs office exit will ensure an evidence in form of a commercial transport manifest or a list of goods/packages in few deliveries in relation to the planned place of unloading. The same serves also when an airplane transporting goods needs to land or stop in an airport outside of the customs territory and the goods remain loaded in the airplane during landing or stopping in an airport outside of the customs territory;</p> <p>4.3.when goods are not unloaded in an airport from the transport means that transported them in the customs territory and who shall transport them outside of the customs territory;</p> <p>4.4.when the goods loaded in a previous airport in the customs territory and remain the means of transport which will transport them outside of the customs territory;</p> <p>4.5.when goods in a temporary storage or a free zone under supervision of the same customs authority are re-loaded from the transport means which transported them up to that facility for temporary storage or free zones in an airplane or wagon which will be</p>	<p>4.Izlazna sigurnosna sažeta deklaracija nije potrebna:</p> <p>4.1.u slučajevima iz člana 93/Ç ove uredbe;</p> <p>4.2.kada se roba utovaruje na aerodromu na carinskom području, a postupak će završiti u nekom drugom aerodromu na carinskom području, pod uslovom da se izlaznoj carinarnici pruži dokaz u obliku komercijalnog, pristanišnog ili prevoznog manifesta ili popisa robe / paketa u pojedinoj pošiljci u pogledu planiranoga mjesta istovara. Isto važi kada vazduhoplov koji prevoze robu trebaju sletjeti na aerodromu izvan carinskog područja, a ta roba ostaje utovarena na vazduhoplovu tokom slijetanja na aerodromu izvan carinskog područja;</p> <p>4.3.kada na aerodromu roba nije istovarena sa prevoznog sredstva koje je prevezlo na carinsko područje i koje će je prevesti izvan carinskog područja;</p> <p>4.4.kada je roba bila utovarena u prethodnom aerodromu na carinskom području i ostaje na prevoznom sredstvu koje će je prevesti izvan carinskoga područja;</p> <p>4.5.kada se roba u privremenom smještaju ili u slobodnoj zoni pod nadzorom istog carinskog organa pretovaruje iz prevoznog sredstva koje je dovelo do tog objekta za privremeni smještaj ili slobodne zone na vazduhoplov ili vagon koji će je iz toga</p>
--	--	--

<p>objekt për strehim të përkohshëm ose zona të lira, që do t'i transportojnë jashtë territorit doganor, me kusht që:</p> <p>4.5.1. Ri-ngarkimi bëhet katërmbëdhjetë (14) ditë pasi që malli është paraqitur për strehim të përkohshëm apo për zonë të lirë. Në rrethana të jashtëzakonshme, Dogana e Kosovës, mund ta vazhdojë këtë afat në mënyrë që të zgjidhen këto rrethana;</p> <p>4.5.2. informacionet për mallin janë në dispozicion të Doganës së Kosovës;</p> <p>4.5.3. destinacioni i mallrave dhe marrësi nuk ndryshojnë sipas dijenisë së transportuesit;</p> <p>4.5.4. kur dëshmia se mallrat që largohen nga territori doganor janë mbuluara paraprakisht nga një deklaratë doganore dhe se të dhënat nga deklarata përmbledhëse dalëse i janë vënë në dispozicion zyrës doganore dalëse nëpërmjet sistemit të përpunimit e të dhënave të pronarit të strehimit të përkohshëm, transportuesit ose drejtuesit të aeroportit ose nëpërmjet një sistemi tjetër komercial të përpunimit e të dhënave, me kusht që ata të kenë marrë miratimin e autoritetit doganor.</p> <p>5. Përjashtimisht nga neni 366/D i këtij Udhëzimi Administrativ, në rastet e referuara në paragrafin</p>	<p>transferred from that facility for temporary storage or free zones, shall transport them outside of the customs territory, provided that:</p> <p>4.5.1.the re-loading is done 14 days after the goods are submitted for temporary storage or free zone. In special circumstances, customs may extent this period of time in order for these circumstances to be solved;</p> <p>4.5.2.the information for goods are available for customs; and</p> <p>4.5.3.the goods destination and the consignee do not change based on transporter's knowledge;</p> <p>4.5.4.when the evidence that goods that will depart from the customs territory are previously covered by a customs declaration and that the data from the exit summary declaration are made available for the customs office of exit through the system for data processing of the temporary storage owner, transporter or airplane pilot or via another commercial system for data processing, provided that they have the customs authority approval.</p> <p>5.Without prejudice to article 366/D of this Instruction, in cases referred in paragraph 4, of</p>	<p>objekta za privremeni smještaj ili slobodne zone prevesti izvan carinskoga područja, pod uslovom da:</p> <p>4.5.1.pretovar se obavlja 14 dana od dana kada je roba podnesena za privremeni smještaj ili u slobodnu zonu. U izuzetnim okolnostima, Carina Kosova može produžiti ovaj rok kako bi se riješile te okolnosti;</p> <p>4.5.2.informacije o robi dostupne su Carini Kosova; i</p> <p>4.5.3.odredište robe i primalac se prema saznanju prevoznika ne mijenjaju;</p> <p>4.5.4.kada je dokaz da je roba koja će se izvesti sa carinskog područja već bila pokrivena carinskom deklaracijom te su podaci iz izlazne sigurnosne sažete deklaracije dati na raspolaganje izlaznoj carinarnici kroz sistem za obradu podataka vlasnika privremenog smještaja, prevoznika ili upravnika aerodroma, ili kroz neki drugi komercijalni sistem za obradu podataka, pod uslovom da su dobili odobrenje carinskog organa.</p> <p>5.Ne dovodeći u pitanje član 366/D ovog uputstva, u slučajevima iz stava 4 ovog člana,</p>
---	--	--

<p>4 të këtij neni, kontrollet doganore do të marrin parasysh natyrën dhe situatat e veçanta.</p> <p>6. Deklaratën përmbledhëse dalëse, kur kërkohet e paraqet transportuesi. Këtë deklaratë e paraqet pronari i objektit për strehim të përkohshëm apo pronari i objektit për vendosje në zonën e lirë, apo ndonjë person tjetër që mundet ta paraqesë mallin, kur transportuesi është njoftuar dhe ka dhënë pëlqimin e tij në bazë të marrëveshjes kontraktuale, se ky person e paraqet deklaratën. Zyra doganore dalëse mundet të supozojë, përveç në rastet kur ka të dhëna që tregojnë të kundërtën, se transportuesi ka dhënë pëlqimin e tij sipas marrëveshjes kontraktuale dhe se deklarata është paraqitur me dijeninë e tij.</p> <p>7.Në rastet kur pas paraqitjes së deklaratës përmbledhëse dalëse, mallrat nuk kanë për qëllim të largohen jashtë territorit doganor, personi që merr mallrat nga autoriteti doganor i daljes për qëllime të transportit në një vend brenda territorit doganor, duhet t'i sigurojë autoritetit doganor dalës informacionin mbi numrin e ngarkesës ose numrin e dokumentit të transportit dhe numrin e paketave ose, nëse mallrat janë në konteinerë, numrin e identifikimit të pajisjes dhe numrin e deklaratës së eksportit, nëse është lëshuar. Këto informacione ofrohen në çdo mënyrë.</p>	<p>this article, customs controls shall consider the nature and special situations.</p> <p>6.The exit summary declaration, when requested, is submitted by the transporter. However, this declaration is submitted by the owner of the facility for temporary storage or the owner of the facility for placement in free zone, or another person that may present the goods, when the transporter is notified and offered his consent based on a contractual agreement, that this person shall submit the declaration. The customs office of exit may suggest, except in cases when there are data which prove the opposite that the transporter gave his consent based on the contractual agreement and the declaration is submitted with his knowledge.</p> <p>7.In cases when after the submission of the exit summary declaration, goods are not intended to depart from the customs territory, the person taking the goods from the customs authority of exit for transport purposes in a place inside of the customs territory shall provide the customs authority of exit with the information on the number of consignment or the number of transport document and number of packages or, if goods are in containers, equipment identification number and export declaration number, if issued. This information may be provided in every manner.</p>	<p>carinske kontrole uzimaju u obzir posebnu prirodu situacije.</p> <p>6.Izlaznu sigurnosnu sažetu deklaraciju, kada je ona potrebna, podnosi prevoznik. Tu deklaraciju podnosi vlasnik objekta za privremeni smještaj ili vlasnik objekta za smještaj u slobodnoj zoni, ili neko drugo lice koje može podnijeti robu, kada je prevoznik obaviješten i dao je svoj pristanak na osnovu ugovornog dogovora, da ovo lice podnosi deklaraciju. Izlazna carinarnica može pretpostaviti, osim kada postoje dokazi koji ukazuju na suprotno, da je prevoznik dao svoj pristanak na osnovu ugovornog dogovora i da je deklaracija bila podnesena uz njegovo znanje.</p> <p>7.U slučajevima kada nakon podnošenja izlazne sigurnosne sažete deklaracije roba više nije namijenjena za iznošenje izvan carinskoga područja, lice koje uzima robu od izlaznog carinskog organa radi prevoza na mjesto unutar carinskog područja pruža izlaznom carinskom organu informacije o broju pošiljke ili broju prevozne isprave te broju paketa ili, ako je roba u kontejnerima, o identifikacionom broju opreme te o broju izvozne deklaracije ukoliko je on bio izdan. Te se informacije mogu pružiti u bilo kojem obliku.</p>
---	---	--

Neni 366/B	Article 366/B	Član 366/B
<p>1.Deklarata e lëshuar përmbledhëse dalëse paraqitet në mënyrë elektronike. Ajo përmban të gjitha të dhënat që janë përcaktuar për këtë lloj deklarate dhe plotësohet në mënyrën e duhur. Deklaratën përmbledhëse dalëse e verifikon personi i cili e ka paraqitur atë.</p> <p>2. Dogana e Kosovë evidenton deklaratën përmbledhëse dalëse, e cila është paraqitur në mënyrën e duhur menjëherë pasi të pranohet. Në këtë rast, neni 106 i Udhëzimit Administrativ bazik zbatohet në mënyrën e duhur.</p> <p>3.Dogana e Kosovës lejon paraqitjen e deklaratës përmbledhëse dalëse në formë të shkruar vetëm në këto raste:</p> <p>3.1.nëse sistemi doganor i informacionit nuk është në funksion;</p> <p>3.2. nëse aplikacioni elektronik i personit që e ka paraqitur deklaratën përmbledhëse dalëse nuk është në funksion;</p> <p>3.3.në rastet nga paragrafi 3 të këtij neni, deklarata përmbledhëse dalëse në formë të shkruar paraqitet në mënyrën e përcaktuar.</p> <p>4.Dogana e Kosovës përcakton procedurën e cila zbatohet në rastet nga paragrafi 3 i këtij neni.</p>	<p>1.The issued exit summary declaration is submitted electronically. It contains all the data which are determined for this type of declaration and is filled in appropriately. The exit summary declaration is verified by the person submitting it.</p> <p>2.Customs shall register the exit summary declaration which was appropriately submitted, immediately after it's received. In this case Article 106 of the Administrative Instruction shall be implemented as required.</p> <p>3.Customs allows the submission of the exit summary declaration in writing only in these events:</p> <p>3.1.if the customs information system is not functioning;</p> <p>3.2.if the electronic application of the person submitting the exit summary declaration is not functioning;</p> <p>3.3.In events from paragraph 3, clause a and b of this article, the exit summary declaration in writing shall be submitted in the manner determined.</p> <p>4.Customs shall determine the procedure which will be implemented in cases from paragraph 3 of this article.</p>	<p>1.Izlazna sigurnosna sažeta deklaracija podnosi se elektronskim putem. Ona sadrži podatke koji su propisani za takvu vrstu deklaracije i popunjava se na propisani način. Izlaznu sigurnosnu sažetu deklaraciju ovjerava osoba koja ju je podnijela.</p> <p>2.Carina Kosova evidentira izlaznu sigurnosnu sažetu deklaraciju koja je podnijeta na propisan način odmah po njenom prijemu. U tom slučaju, član 106 bazičnog Administrativnog Uputstva primjenjuje se na odgovarajući način.</p> <p>3.Carina Kosova dopušta podnošenje pisane izlazne sigurnosne sažete deklaracije samo u sljedećim slučajevima:</p> <p>3.1.ako carinski informacioni sistem nije u funkciji;</p> <p>3.2.ako elektronska aplikacija lica koje podnosi izlaznu sigurnosnu sažetu deklaraciju nije u funkciji;</p> <p>3.3.U slučajevima iz stava 3 tač. a i b ovog člana, pisana izlazna sigurnosna sažeta deklaracija podnosi se na propisani način.</p> <p>4.Carina Kosova utvrđuje proceduru koja će se primenjivati u slučajevima iz stava 3 tačka a ovog člana.</p>

<p>5.Dogana e Kosovës miraton përdorimin e deklaratës përmbledhëse në formë të shkruar nga paragrafi 3 dhe nën paragrafi 3.2 të këtij neni.</p> <p>6. Deklaratën përmbledhëse dalëse në formë të shkruar e nënshkruan personi i cili e lëshon atë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 366/C</p> <p>1. Në rastin e transportit të kombinuar, kur malli bartet nga një mjet transportues në tjetrin jashtë territorit doganor, afati për paraqitjen e deklaratës së shkurtër dalëse korrespondon me afatin që zbatohet për mjetet e transportit që e lëshojnë territorin doganor, siç është përcaktuar me nenin 366/Ç, paragrafi 1 i këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p>2.Në rast të transportit të kombinuar, me ç’ rast mjetit aktiv transportues i cili e kalon kufirin vetëm e bartë mjetin tjetër transportues, transportuesi i mjetit tjetër është i obliguar, që ta paraqesë deklaratën e shkurtër dalëse.</p> <p>3.Afati për paraqitjen e deklaratës korrespondon me afatin që zbatohet për mjetin aktiv transportues i cili e kalon kufirin, siç është përcaktuar me nenin 366/Ç, paragrafi 1 i këtij Udhëzimi Administrativ.</p>	<p>5.Customs shall approve the use of the summary declaration in writing from paragraph 3, clause 3.2 of this article.</p> <p>6.The exit summary declaration in writing shall be signed by the person issuing it.</p> <p style="text-align: center;">Article 366 /C</p> <p>1.In case of the combined transport, when the goods are carried from one to another transport mean outside of customs territory, the period of time for submitting the short declaration of exit shall correspond with the period of time implemented for means of transport departing from the customs territory, as determined by article 366/Ç, clause 1 of this Instruction.</p> <p>2.In case of the combined transport, in which event the active means of transport that crosses the border by carrying only one means of transport, the other means of transport transporter is obliged to submit the short exit declaration.</p> <p>3.The period of time to submit the declaration shall correspond with the period of time which is implemented for the active means of transport that crosses the border, as determined by article 366/Ç, clause 1 of this Instruction.</p>	<p>5.Carina Kosova odobrava upotrebu izlazne sigurnosne sažete deklaracije u pisanoj formi iz stava 3. tačka 3.2 ovog člana.</p> <p>6.Izlaznu sigurnosnu sažetu deklaraciju u pisanom obliku potpisuje osoba koja je izdaje.</p> <p style="text-align: center;">Član 366/C</p> <p>1.U slučaju kombinovanog prevoza, kada se roba prenosi iz jednog prevoznog sredstva u drugo za prevoz izvan carinskog područja, rok za podnošenje izlazne skraćene deklaracije odgovara roku koji se primjenjuje na prevozno sredstvo koje napušta carinsko područje, kao što je utvrđeno članom 366/Č stav 1 ovog Uputstva.</p> <p>2. U slučaju kombinovanog prevoza, pri čemu aktivno prevozno sredstvo koje prelazi granicu samo prevozi drugo aktivno prevozno sredstvo, prevoznik drugog prevoznog sredstva je obavezan podnijeti izlaznu skraćenu deklaraciju.</p> <p>3.Rok za podnošenje deklaracije odgovara roku koji se primjenjuje na aktivno prevozno sredstvo koje prelazi granicu, kao što je utvrđeno članom 366/Č, stav 1 ovog uputstva.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 366/Ç</p>	<p style="text-align: center;">Article 366/Ç</p>	<p style="text-align: center;">Član 366 /Ç</p>
<p>1. Deklarata përmbledhëse dalëse i dorëzohet zyrës doganore dalëse në këto afate:</p> <p>1.1. për ngarkesat refuz/ngarkesë e përgjithshme, së paku katër (4) orë para nisjes nga zyra doganore dalëse.;</p> <p>1.2. në transportin ajror, së paku tridhjetë (30) minuta para nisjes nga aeroporti në territorin doganor;</p> <p>1.3. në rast të transportit hekurudhor, së paku dy (2) orë para nisjes nga zyra doganore dalëse;</p> <p>1.4. në rast të transportit rrugor, së paku një (1) orë para nisjes nga zyra doganore dalëse.</p> <p>2. Dogana e Kosovës, pas paraqitjes së deklaratës përmbledhëse dalëse, kryen kontroll të përshtatshme duke u bazuar në risk, veçanërisht për qëllime të sigurisë, përpara lëshimit të mallrave për dalje nga Kosova dhe për një periudhë që korrespondon me periudhën e afatit për paraqitjen e deklaratës së përcaktuar për llojin e veçantë të transportit dhe ngarkimin ose dërgimin e mallrave.</p> <p>3. Nëse mallrat e përfshira me një nga lirimet nga kërkesa për deklaratën përmbledhëse dalëse, të përcaktuar në nenin 366/A paragrafi 4 të këtij</p>	<p>1. The exit summary declaration is submitted in the customs office of exit during these periods of time:</p> <p>1.1. for consignments in bulk, at least 4 hours prior to departing from the customs office of exit;</p> <p>1.2. in air transport, at least 30 minutes prior to departing from the airport of the customs territory;</p> <p>1.3. in case of railway transport, at least (2) hours prior to departing from the customs office of exit;</p> <p>1.4. in case of road transport, at least (1) hour prior to departing from the customs office of exit.</p> <p>2. The competent customs authority, after submission of the exit summary declaration, shall perform adequate controls based on risk, especially for safety purposes, prior to releasing the goods on exit from Kosovo and for a period of time which corresponds with the period of time for submitting the declaration stipulated for the special type of transport and loading or delivery of goods.</p> <p>3. If the goods involved in one of the releases from the request for exit summary declaration, determined in article 366/A, paragraph 4 of this Instruction, they shall be extracted from the</p>	<p>1. Izlazna sigurnosna sažeta deklaracija se podnosi izlaznoj carinarnici u sljedećim rokovima:</p> <p>1.1. za teret u rasutom stanju/generalni teret, najmanje četiri (4) sata prije odlaska iz izlazne carinarnice;</p> <p>1.2. u vazдушnom saobraćaju, najmanje trideset (30) minuta prije odlaska sa aerodroma na carinskom području;</p> <p>1.3. u slučaju željezničkog saobraćaja najmanje dva (2) sata prije odlaska iz izlazne carinarnice;</p> <p>1.4. u slučaju drumskog saobraćaja, najmanje jedan (1) sat prije odlaska iz izlazne carinarnice.</p> <p>2. Carina Kosova po podnošenju izlazne sigurnosne sažete deklaracije obavlja odgovarajuće kontrole koje se zasnivaju na riziku, prvenstveno u svrhu bezbjednosti i sigurnosti, prije puštanja robe za izlaz iz Kosova te u razdoblju koje odgovara razdoblju između roka za podnošenje deklaracije za određenu vrstu prevoza i utovara ili otpreme robe.</p> <p>3. Ako se roba obuhvaćena jednim od oslobođenja od zahtijeva za izlaznom sigurnosnom sažetom deklaracijom utvrđenom u članu 366/A, stav 4 ovog uputstva iznosi sa</p>

